



Zëri i

Grave të Kosovës

Duke përkrahur, mbrojtur dhe promovuar
të drejtat dhe interesat e grave dhe grave të Kosovës

tetor 2012



Qindra 'Ecin për Shërim', për të ngritur vetëdijen lidhur me kancerin e gjirit dhe për të kërkuar reagim më të mirë institucional, në këtë eveniment të organizuar nga Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit 'Jeta/Vita' më 5 tetor.

Në këtë numër

[Drejtesia për Gratë e Përdhunuar
Prioritet në Negociatat e Kosovës,
thonë Aktivistët](#)

[Publikohet Hulumtimi Novator mbi
Koston e Dhunës në Familje në
Kosovë](#)

[Jeta-Vita Grumbullon Qindra
Pjesëmarrës në Marshin kundër
Kancerit të Gjirit](#)

[Ministria e Shëndetësisë, UNFPA
dhe RRGGK Fuqizojnë Reagimin e
Punonjësve Shëndetësor ndaj
Dhunës në Baza Gjimore](#)

[Martesat e Hershme Vazhdojnë të
Ndodhin në Kosovë](#)

[Qëndrueshmëria e Lëvizjes:
Anëtarët e RRGGK-së Kërkojnë të
Përfshijnë Aktiviste të Reja](#)

[Nisma për Historinë Orale Kërkon
të Dokumentojë Jetët e Grave
Kosovare](#)

[Grupet për barazi gjinore
avokojnë për të drejtat e grave në
komunitetet e Kosovës](#)

[Dera e Hapur Organizon Panairin
e Tetë Vjetor Artizanal](#)

[Anëtarët e RRGGK-së Diskutojnë
Qëndrueshmërinë Financiare,
Fondin e Grave të Kosovës](#)

RRGGK Lanson Një Fond të Ri të Grave dhe Ndan Grantet e Para

Ndryshimi i prioriteteve për ndihmesë dhe zvogëlimi i buxheteve kanë bërë që shumë donatorë në Kosovë të mbyllin programet e tyre të granteve apo të zvogëlojnë fondet për organizata joqeveritare (OJQ). Disa të tjerë kanë fonde në dispozicion, por kanë procedurë të ndërlikuar të aplikimit dhe/ose japin vetëm grante më të mëdha (€50.000-100,000). Aktivistët për të drejtat e grave ankohen se shkrimi i një propozimi për përfitimin e fondeve nga Komisioni Evropian, që është një nga donatorët kryesorë, i ngjan 'shkrimin të një teze të magjistraturës'.

Për këtë arsye, grupet e grave që kanë burime të limituara njerëzore të punësuar me orar të plotë dhe vështirësi me gjuhën angleze hasin në shumë pengesa gjatë sigurimit të fondeve për nismat e tyre tejet të rëndësishme në kuptim të barazisë gjinore dhe avancimit të të drejtave të grave. Ky problem i është paraqitur Rrjetit të Grupeve të Grave (RRGGK) nga organizatat anëtare të saj.

Rrjedhimisht, RRGGK në konsultim të ngushtë me 100 organizatat anëtare të saj kanë vendosur të themelojnë Fondin e Grave të Kosovës. Ky fond, i cili përkrahët në mënyrë tejet bujare nga Kvinna till Kvinna, ofron grante të vogla (deri në €1,000) për organizatat e grave që kanë qasje të kufizuar në burime tjera të financimit dhe të cilat mëtojnë avancimin e të drejtave të grave, në veçanti mes grupeve rurale, të marginalizuara dhe/apo të cenueshme. Njëkohësisht, RRGGK është duke shfrytëzuar këtë program të granteve për të përkrahur anëtarët e veta në procesin e shkrimit të kërkesave për grante, në mënyrë që të avancohen kapacitetet e tyre për të aplikuar për fonde nga donatorë tjerë në të ardhmen.

Gjithsej 28 anëtare të RRGGK-së kanë parashtruar kërkesat e tyre pranë Fondit të Grave të Kosovës gjatë rëndit të parë të granteve. Komisioni Shqyrtues i Granteve, i zgjedhur mes anëtarëve të RRGGK-së, i ka përzgjedhur 12 përfituesit e granteve në tetor të vitit 2012:

Materiale tjera në internet



Lexoni raportin tonë të ri mbi koston e dhunës në familje në Kosovë!

Bashkëngjituni edhe ju!



Më 3 Nëntor:
[kërkojmë drejtësi dhe dinjitet para negociatave!](#)



[Në Facebook!](#)
[Në "Facebook Group"](#)



[Our E-News mailing list](#)

1. "Gratë për gratë me aftësi të kufizuara" nga Prizreni ka marrë €960 për projektin e tyre: "E dua jetën ashtu si jam." Qëllimi i këtij projekti është të përmirësohet shëndeti i grave dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore që ato kanë në dispozicion.
2. "Gratë aktive në Gjakovë" ka marrë €630 për "Arsimin e grave rome, ashkali dhe egjiptiane të Gjakovës." Ato mëtojnë të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve shëndetësore në dispozicion për këto gra.
3. "Ardhmëria më e bukur" nga Prilluzha ka përfituar €700 për projektin e tyre 'Stop dhunës'. Qëllimi i tij është parandalimi i dhunës në familje dhe ngritja e vetëdijes lidhur me mekanizmat mbrojtës.
4. "Gratë vizionare të shekullit XXI" nga Hasi ka marrë €975 për 'Prezantim të punës së OJQ-së në mediat lokale.' Ato kanë për qëllim sensibilizimin e donatorëve lokalë mbi të nevojat e grave dhe vajzave.
5. "Shoqata e të verbërve" nga Prizreni ka marrë €900 për projektin e tyre: "Të mësojmë të gatujmë," i cili ka për qëllim të mësoj gratë e verbra se si të gatujmë ushqime.
6. Shoqata e pensionistëve VITA-JETA nga Prishtina ka marrë €860 për "mbrojtjen e shëndetit të grave gjatë fazës së tretë të jetës." Caku është të identifikohet dhe parandalohet osteoporosa.
7. "Ato" nga Vushtrria kanë përfituar €895 për "Fushatën edukuese për shëndetin e grave," i cili ka për qëllim informimin e grave dhe vajzave në zona rurale mbi shëndetin reproduktiv të tyre.
8. Iniciativa e Shoqatës së Grave nga Dragashi ka marrë €994 për projektin "Kanceri i gjirit merr jetë." Ato kanë për qëllim shtimin e vetëdijes lidhur me këtë sëmundje në zonat rurale të Dragashit.
9. Shoqata për Arsimim dhe Kujdes Familjar në Gjakovë ka marrë €850 për projektin e tyre "Shëndeti reproduktiv," që ka për synim ngritjen e vetëdijes së grave dhe vajzave lidhur me shëndetin reproduktiv të tyre.
10. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Drenas ka përfituar €620 për "Identifikimin e rasteve të dhunimit në regjionin e Drenasit." Ato mëtojnë të përkrahin reintegrimin e personave të dhunuar në shoqëri.
11. Organizata e Personave me Distrofi Muskulare nga Prizreni ka përfituar €1,000 për projektin, "Edhe ne kemi të drejta." Ajo ka për qëllim përkrahjen e personave me aftësi të kufizuara dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për ta.
12. Arta nga Prishtina ka marrë €820 për projektin "Shtimi i kapaciteteve organizative." Ata synojnë fuqizimin e grave përmes produkteve tradicionale të dorës.

Urime dhe suksese për këto anëtare të RRGK-së. RRGK shpreson të përkrahë edhe organizatat tjera anëtare në të ardhmen. Informata shtesë mbi përfitueset e granteve do të vendosen së shpejti në faqen tonë në internet: www.womensnetwork.org.



RRGK dhe Sevdije Bunjaku, anëtare e Komisionit Shqyrtues të Granteve, përgëzojnë 12 organizatat anëtare të RRGK-së që kanë përfituar grantet e para të ndara nga Fondi i Grave të Kosovës më 24 tetor.

Drejtësia për Gratë e Përdhunuara Prioritet në Negociatat e Kosovës, thonë Aktivistët

Së paku 96 raste të dhunimit të kryera gjatë luftës së vitit që përfundoi në vitin 1999 në Kosovë janë dokumentuar nga Human Rights Watch, ndërsa burime tjera prognozojnë se gjatë luftës janë dhunuar mes 10 dhe 45 mijë gra dhe vajza. 'Dhunimet nuk ishin raste të rralla dhe të izoluar të kryera nga individë, por shfrytëzoheshin qëllimisht si instrument për terrorizimin e popullatës civile, nxirjen e parave nga familjet dhe shtyrjen e njerëzve që të ikin nga vatrat e tyre,' raportonte [Human Rights Watch](#) në vitin 2000. Megjithatë, nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi

ende asnjë person i vetëm nuk është dënuar për dhunë seksuale apo dhunim. As Qeveria e Serbisë nuk e ka pranuar zyrtarisht këtë krim dhe nuk ka kërkuar falje për të.

'Drejtësia është e domosdoshme' tha Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RRGK-së, gjatë **Samitit Ndërkombëtar të Grave** të organizuar në Kosovë më 4-6 tetor nga Presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, me shumë mysafire me nam, përfshirë edhe znj. Madeleine Albright. Një nga rekomandimet që dolën nga kjo konferencë ishte: 'Të konfirmohet se proceset e konfliktit, paskonfliktit dhe të drejtësisë tranzicionale, si dhe institucionet që dalin nga to, të jenë të përgjegjshme në kuptimin gjinor dhe të kenë parasysh statusin ligjor të viktimave të dhunës, të njohin publikisht përvojat e trishta të tyre dhe t'i kompensojnë ato për dëmet e pësuar dhe t'i ndjekin penalisht kryerësit e veprave të tilla.'


Gratë në Kosovë ende nuk kanë parë të jetë zbatuar drejtësi për krimet e kryera në Kosovë gjatë viteve 1998-1999 apo në dekadën që i parapriu këtyre viteve. Krimet e luftës, përfshirë dhunimet, nuk duket se janë trajtuar në tavolinën e bisedimeve nga pala Kosovare, të cilët me bisht nën këmbë kanë vazhduar të kërkojnë njohjen e pavarësisë së Kosovës, e cila u shpall në vitin 2008. Edhe nëse është bërë ndonjëherë ndonjë kërkesë e tillë për drejtësi, këto informata nuk kanë arritur kurrë tek publiku.

Negociatorët duket se kanë injoruar një çështje kyçe – se në Kosovë ka pasur 'ekzekutime të organizuara, vrasjet masive, shkatërrim të pronave civile dhe krime tjera të luftës,' gjë që është dëshmuar dhe dokumentuar nga **Human Rights Watch**. Për më tepër, shkeljet e qarta të të drejtave të shqiptarëve për arsim dhe punë gjatë viteve të 90-ta, kanë pasur ndikim negativ afatgjatë në mirëqenien ekonomike të popullatës.

Duke qenë se negociatat po afrohen, gratë aktiviste të Kosovës **u bëjnë** thirrje negociatorëve që të sigurojnë drejtësi dhe shpazim për krimet e kryera ndaj shqiptarëve të Kosovës, në veçanti për dhunimet e grave dhe vajzave gjatë luftës. RRGK është poashtu pjesë e një nisme regjionale që kërkon drejtësi për dhunimet e kryera gjatë luftës dhe për krimet e kryera gjatë grave viteve të 90-ta.

Publikohet Hulumtimi Novator mbi Koston e Dhunës në Familje në Kosovë

RRGK dhe Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDP) nxorën në tetor një raport mbi koston e dhunës në familje në vend. *Me çfarë çmimi: Buxheti për implementimin e kornizës ligjore kundër dhunës në familje në Kosovë* shfrytëzon një qasje të përgjegjshme gjinore në makronivel për të vlerësuar koston e parandalimit të dhunës në familje, mbrojtjes së viktimave, ndjekjes penale të kryerësve të veprave të dhunës dhe përkrahjes së rehabilitimit dhe reintegrimit të tyre, ashtu siç parashikohet në ligjet e aplikueshme dhe politikat e Kosovës. Në të gjithashtu analizohet buxhetet vjetore dhe afatmesme kombëtare nga perspektiva gjinore. Ky raport mund të gjendet në [ueb-faqen](#) e RRGK-së në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.



Jeta-Vita Grumbullon Qindra Pjesëmarrës në Marshin kundër Kancerit të Gjirit

Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit 'Jeta/Vita' organizoi një 'Ecje për shërim' në Prishtinë më 5 tetor. Në këtë marsh morën pjesë mysafire të shquara, përfshirë deputeten e Parlamentit Evropian dhe raportuesen për Kosovën dhe ambasadorë të ndryshëm në Kosovë. Qindra qytetarë morën pjesë në këtë ngjarje, për të dëshmuar solidaritet me të mbijetuarat e kancerit të gjirit. Kjo ecje ka pasur për qëllim shtimin e nivelit të vetëdijes mes grave dhe në shoqëri sa i përket kancerit të gjirit, që besohet se është duke shënuar shtim në Kosovë, ku mundësitë për zbulim të hershëm dhe trajtim janë të limituara. Në të njëjtën ditë ato lansuan një peticion të lansuar nga Qendra e Grave Prehja në Skenderaj, me të cilën kërkohet shfrytëzimi i pajisjeve të rrezatimit që kanë mbetur në bodrum të Institutit të Onkologjisë. Anëtarët e RRGK-së po vazhdojnë të grumbullojnë nënshkrime nëpër komunitetet e tyre, ndërsa peticioni mund të nënshkruhet edhe duke kontaktuar RRGK-në në adresën



Qindra persona janë mbledhur për të ngritur vetëdijen lidhur me kancerin në gji, duke kërkuar veprime institucionale.

Ky marsh ishte një nga evenimentet e organizuara gjatë tetorit, Muajit Ndërkombëtar Kundër Kancerit të Gjirit. Dy klinika private gjithashtu kanë ofruar kontrolle me mamograf pa pagesë gjatë këtij muaji: Spitali Amerikan dhe Aloka.

Grupi i Grave Deputete ngritë vetëdijen për Muajin kundër Kancerit të Gjirit nëpërmjet një posteri të vendosur në ndërtesën e parlamentit.



Ministria e Shëndetësisë, UNFPA dhe RRGGK Fuqizojnë Reagimin e Punonjësve Shëndetësor ndaj Dhunës në Baza Gjinore

Si pjesë e përpjekjeve të një Ekipi të OKB-së për Kosovën për të fuqizuar kapacitetet dhe qëndrueshmërinë financiare të mekanizmave për mbrojtje nga dhuna në familje, RRGGK është duke bashkëpunuar me UNFPA dhe Ministrinë e Shëndetësisë për ngritjen e kapaciteteve institucionale të sektorit shëndetësor për të adresuar dhunën në baza gjinore. Grupi Punues i Ministrisë së Shëndetësisë, që përfshinte një përfaqësues të RRGGK-së në radhët e ekspertëve, është pranë



Ekspertët e RRGGK-së ofrojnë shpjegime lidhur me legjislacionin për luftimin e dhunës në familje, për pjesëtarë të shoqërisë civile, policisë dhe institucionet tjera në Gjilan më 22-23 mars.

finalizimit të plan-programit për trajnimet për punonjësit shëndetësorë në identifikimin e shenjave dhe trajtimin e personave që kanë përjetuar dhunë në baza gjinore. Gjithashtu, RRGGK ka ofruar trajnime për OJQ-të në tri komuna pilot (Gjilan, Gjakovë dhe Dragash) lidhur me trajtimin dhe avokimin për përmirësim të reagimit institucional ndaj dhunës në baza gjinore.

Martestat e Hershme Vazhdojnë të Ndodhin në Kosovë

Martestat e hershme vazhdojnë të ndodhin në Kosovë, por kjo dukur nuk është caktuar si prioritet për qeverinë apo institucionet e Kosovës. Policia dhe prokurorët nuk e zbatojnë gjithmonë ligjin, i cili ndalon martesat para moshës 16 vjeçe, dhe përcakton kufizime deri në moshën 18 vjeçe. Në vend të kësaj, ata e arsyetojnë këtë me "norma kulturore". Gjersa martesat e hershme janë raportuar në radhët e të gjitha grupeve etnike, ato janë më shpesh paraqiten te komuniteti rom, ashkali, egjiptian dhe goran (përkundër të dhënave të pamjaftueshme statistikore).

Këto ishin disa nga konkluzat e Fletës Informative të Fondit për Popullsi të OKB-së (UNFPA), të publikuar në shënimin e përvjetorit të parë të Ditës së Fëmijës Vajzë, më 11 tetor.

"Ai më rrahu dy herë. Më kujtohet që hera e parë ishte sepse nuk e kisha mbushur telefonin e tij," tha një bashkëshorte e mitur për UNFPA. "Unë nuk kisha fare njohuri për kontraceptivët apo kondomët. Përndryshe nuk do të kisha mbetur shtatzënë dhe nuk do të martohesha. Askush nuk mi ka mësuar këto gjëra," tha një tjetër bashkëshorte e mitur. Dëshmitë sugjerojnë se martesat e hershme mund të vënë bashkëshortet e mitura, posaçërisht vajzat dhe gratë e reja, në situata të pabarabarta, madje disa here edhe në dhunë në shtëpi.

Në disa raste, vakumet ligjore mundësojnë që të shkelen të drejtat e bashkëshorteve të mitura. Sipas këtij raporti, të hartuar nga hulumtuesja e pavarur (dhe anëtare e RRGGK-së) Nicole Farnsworth, Ligji për Familjen nuk përkufizon qartë nëse një fëmijë bëhet i rritur pas martesës. Gjithashtu, ai nuk përkufizon anëtarët e anëtarët e "organizatave kujdestar" të cilit i drejtohet gjykata për këshillim profesional nëse fëmijët janë gatshëm (të pjekur) për martesë. Për sa i përket kujdesit shëndetësor, prindërit mund të përfshihen në përzgjedhjet riprodhuese të bashkëshorteve të reja, si për shembull sa fëmijë do t'i ketë çifti. Një gjë e tillë prek të drejtat e bashkëshorteve të mitura për të vendosur lidhur me kohën dhe hapësirën ndërmjet shtatzënive.

Qasja më e mirë në informata lidhur me të drejtat riprodhuese, rishikimi i Ligjit për Familjen, procedurat më të qarta institucionale lidhur me këtë çështje, si dhe sigurimi i shkollimit të obligueshëm fillor dhe të mesëm për të gjithë fëmijët janë disa nga rekomandimet e ofruara.

Fleta Informative mund të gjendet së shpejti në Anglisht, Shqip dhe Serbisht në: www.unfpakos.org.



Gjejrane Lokaj, anëtare e RRGGK-së, prezanton sfidat në parandalimin e martesave të hershme në komunën e Dragashit në Ditën e Fëmijës Vajzë, të organizuar nga UNFPA.

Qëndrueshmëria e Lëvizjes: Anëtarët e RRGK-së Kërkojnë të Përfshijnë Aktiviste të Reja

Më shumë se dy dekada të përpjekjeve që të dëgjohen zërat e tyre kanë shterur energjitë e aktivisteve femra. Shumica e aktivisteve në Kosovë janë duke u organizuar që nga vitet e 1990-ta, nëse jo edhe më e herët. Lidershipi i lëvizjeve të grave të Kosovës po plaket. E vërteta e vështirë por për të cilën po flitet pak është se udhëheqëset e shumicës së organizatave të grave në Kosovë janë mbi moshën 45 vjeçe. Për të diskutuar për këtë çështje të rëndësishme dhe mënyrën se si të përfshihen më shumë femra të reja në lëvizjet e grave në Kosovë, RRGK ka organizuar një seminar treditor të titulluar "Qëndrueshmëria e organizimit të grave në Kosovë" në tetor të vitit 2012 në Durrës të Shqipërisë.

Kjo ngjarje kishte në fokus mbajtjen e aktivizmin e aktivisteve si dhe përfshirjen e femrave të reja në organizime të grave. RRGK ka krijuar një hapësirë të sigurt dhe një mjedis relaksues për t'i diskutuar këto çështje sfiduese. Anëtarët kanë diskutuar si të përfshihen femrat e reja në lëvizje; si të mobilizohen aktiviste të reja; si zhvillohen aftësitë e lidershipit; dhe si të shtohet demokracia e brendshme në organizata. Një seancë e veçantë dhe e gjallë e drejtuar nga anëtarja e re e RRGK-së, Art Police, futi anëtarët tjera në lojë të roleve, duke demonstruar sfidat në demokracinë brenda organizatave, si dhe duke ofruar disa zgjidhje.

Në mbrëmje, RRGK dhe Kvinna till Kvinna organizuan aktivitete të kohës së lirë për aktivistet, përfshirë joga dhe një aheng, duke kontribuar në mirëqenien dhe energjinë e aktivisteve.

"Ju falënderoj shumë për këto tri ditë të shkëlqyeshme të punës dhe kënaqësisë," tha një anëtare e RRGK-së. "Nëse punojmë së bashku, ne mund t'i tejkalojmë pengesat."

Nisma për Historinë Orale Kërkon të Dokumentojë Jetët e Grave Kosovare

Gjatë verës, RRGK ka lansuar një nismë të re për dokumentimin e historive jetësore të grave të ndryshme në Kosovë. Janë realizuar tri intervista me gra aktiviste, si dhe do të realizohen intervista të tjera. Gjithashtu, kjo nismë përfshin dokumentimin e jetëve të grave të cilat kanë marrë pjesë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), si dhe mbështetjen e ofruar për to në publikimin e një libri që përvijon jetët e tyre para, gjatë dhe pas përfshirjes së tyre në UÇK. Është posaçërisht e rëndësishme që të kuptohet roli që gratë kanë luajtur gjatë luftës së viteve 1998-1999 për shkak të mungesës së njohjes publike për këtë grup të veçantë dhe mungesës së tyre pasuese të dukshmërisë në projektin e shtetndërtimit pas pavarësisë. Intervistat kanë filluar në gusht dhe do të vazhdojnë deri kur të kenë marrë pjesë të gjitha femrat e gatshme. Deri më sot, historitë e tyre i kanë ndarë gjashtë femra. Femrat tjera të interesuara që t'i ndajnë historitë e tyre mund të kontaktojnë info@womensnetwork.org.

Kjo nismë për histori orale ka pranuar mbështetje nga Universiteti New School, posaçërisht nga Dr. Anna Di Lellio; kandidatja për doktoratë në Universitetin Goldsmiths, Virginia Stephens; producentja e filmave Kaltrina Krasniqi; si dhe shumë aktiviste, hulumtuese dhe përkthyes të tjera, të cilat kanë dhuruar kohën e tyre për këtë nismë të rëndësishme.

Grupet për Barazi Gjinore Avokojnë për të Drejtat e Grave në Komunitet e Kosovës

Që nga qershori i vitit 2011, RRGK ka mbështetur themelimin e Grupeve Avokuese për Barazi Gjinore në tetë komuna. Këto grupe në radhët e tyre mbledhin delegate femra të kuvendeve komunale, aktivistë të shoqërisë civile, avokues të barazisë gjinore dhe palë të tjera të interesit për të diskutuar lidhur me sfidat për barazinë gjinore dhe vështirësitë më të mëdha me të cilat përballen gratë në nivel komunal. Këto grupe janë themeluar në Dragash, Gjakovë, Pejë, Mamushë, Novobërdë, Gjilan, Prizren dhe Mitrovicë.

Në mesin e dhjetëra takimeve të organizuara me këto grupe gjatë disa muajve të fundit, Grupet Avokuese për Barazi Gjinore në Dragash, Mamushë dhe Prizren patën mundësinë që të takohen me Deputetë në Dragash më 10 tetor. Gratë Deputete treguan shembuj të përvojave të tyre të fundit në tejkalimin e vijave partiake për të evokuar për çështjet që kanë ndikim në të gjitha gratë, siç janë dhuna në familje, shëndetësia dhe përdhunimet gjatë luftës. Deputetet e kuvendeve komunale mund të ndërmarrin nisma të ngjashme, thanë ato.

Deri më sot, Grupet Avokuese për Barazi Gjinore kanë ndërmarrë nisma të ndryshme avokuese drejt barazisë gjinore



Anëtarja e Asamblesë në Dragash Luljeta Berisha thekson rëndësinë e kujdesit të fëmijëve për fuqizimin ekonomik të grave; dhe inkurajon gratë votuese të përkrahin gratë kandidate.

brenda komunave të tyre, shumica prej të cilave janë ende në vazhdim e sipër. Për shembull, në Dragash, Grupi Avokues për Barazi Gjinore tërhoqi vëmendjen e zyrtarëve se transportimi i pamjaftueshëm publik është pengesë për gratë që të udhëtojnë nga Dragashi për në Prizren dhe qytetet tjera për punë apo shkollim. Që atëherë, kjo komunë ka instaluar një shërbim të rregullt të transportit publik.

Puna e RRGK-së me Grupet Avokuese për Barazi Gjinore aktualisht gëzon mbështetje të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës dhe organizatës Kvinna till Kvinna. Kjo nismë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, me qëllim të rritjes së barazisë gjinore në të gjitha komunat e Kosovës.

Dera e Hapur Organizon Panairin e Tetë Vjetor Artizanal

Që nga viti 2005, organizata anëtare e RRGK-së, Dera e Hapur ka organizuar Panairin vjetor artizanal dhe kulturor për të shënuar Ditën Evropiane të Trashëgimisë. Më 25-27 shtator, ata kanë organizuar panairin e tetë të radhës në Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryetarin e Komunës së Prishtinës, Isa Mustafën. Panairi ka ofruar mundësinë për 84 zejtarë pjesëmarrës nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, si dhe anëtarë të organizatave të ndryshme të gruas, që t'i ekspozojnë produktet e tyre.



"Panairi i Artizinateve është manifestimi më i madh i zejtarëve në vendin tonë dhe përbën një kontribut të veçantë për trashëgiminë kulturore të Kosovës," tha Belgjzare Muharremi, Drejtore Ekzekutive e organizatës Dera e Hapur.

Zejtarët kanë përdorur materiale të ndryshme përfshirë gurë, tekstil dhe dru. Gjithashtu, vizitorët patën mundësinë që të provojnë mostra dhe të blejnë ushqime të ndryshme tradicionale.

"Ky panair ishte i suksesshëm për organizatat e grave," shtoi Belgjzare Muharremi. "Ata kanë shitur shumë produkte dhe kanë identifikuar konsumatorë të rinj. Ky panair ka promovuar punën e tyre dhe njëkohësisht i ka ndihmuar ata të krijojnë të ardhura dhe të përmirësojnë pozitën e tyre në shoqëri."

Në të vërtetë, zejtarët kanë raportuar se kanë krijuar mijëra euro të hyra gjatë panairit të këtij viti.

Anëtarët e RRGK-së Diskutojnë Qëndrueshmërinë Financiare, Fondin e Grave të Kosovës

Gratë e organizuara në Kosovë përballen me sfida të shumta. Gjersa shumica e donatorëve kanë filluar të tërhiqen nga Kosova, apo të zvogëlojnë mbështetjen e tyre, organizatat e grave përballen me sfida vendimtare të qëndrueshmërisë. Prandaj, në korrik të vitit 2012, RRGK, me mbështetje të organizatës Kvinna till Kvinna, mbajti një seminar dyditor me temë "Qëndrueshmëria e organizimit të gruas në Kosovë" në Prishtinë. Ky seminar kishte në fokus qëndrueshmërinë financiare dhe ekonomike të organizatave të grave.

Diskutimet u përqendruan kryesisht rreth idesë për themelimin e një fondi të grave për të mbështetur organizatat anëtare të RRGK-së. Anëtarët e RRGK-së diskutuan në mënyrë aktive lidhur me kriteret për kualifikim, procedurat për aplikim, si dhe anëtarët e mundshëm të Komisionit Përzgjedhës të Grantit. Së bashku ata hartuan planet për një fond që do t'i shërbente nevojat e tyre. Ata u pajtuan se aktivitetet e përfuturësve të granteve do të kontribuonin në realizimin e misionit dhe strategjisë së RRGK-së (të krijuar nga anëtarët e RRGK-së).

Si rrjedhojë e këtij procesi pjesëmarrës dhe me mbështetjen zemërgjerë të organizatës Kvinna till Kvinna, u themelua **Fondi për Gratë e Kosovës** të RRGK-së.

"Ne kemi nevojë për këtë fond për të ardhmen e organizatave tona," tha një anëtare e RRGK-së. "Unë jam shumë falënderuese për RRGK-në sepse gjatë këtij takimi ne edhe kaluam kohë të mirë edhe punuam shumë."



Në tetor, anëtarët e RRGK-së dhe Grupi Gjinor për Siguri kanë grumbulluar më shumë se €500 për një foshnje për të siguruar një intervenim kirurgjik për të larguar ujin në tru, në Itali. Kjo nismë është organizuar nga Antonella, pronarja e restorantit *Il Passatore*, duke shpëtuar jetën e djalit të vogël.